



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË

Nr. 4132 prot.

Himarë, më 08.06.2026

NJOFTIM

PËR RIJETËSIMIN E VENDIMIT NR.34, DATË 09/07/2025 “PËR MIRATIMIN E KAHUT TË LËVIZJES, ORARIT TË LËVIZJES DHE KUFIZIMIT TË QARKULLIMIT NË DISA AKSE TË BRENDSHME SË MJETEVE AUTOMOBILISTIKE NË QYTETIN E HIMARËS” TË KËSHILLIT BASHKIAK HIMARË

BANORËVE TË KOMUNITETIT TË QYTETIT HIMARË

Në zbatim të ligjit nr. 139/ 2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjin nr. 8378/1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë” (i përditësuar datë 16/03/2023), ligjin nr.89/2022 “Për policinë bashkiake”, VKM-në nr. 153, datë 07.04.2000 “Për miratimin e rregullores së zbatimit të Kodit Rrugor të Republikës Së Shqipërisë” (përditësuar me VKM nr.322, datë 29/05/2024), Vendimit nr.34, datë 09/07/2025 “Për miratimin e kahut të lëvizjes, orarit të lëvizjes dhe kufizimit të qarkullimit në disa akse të brendshme së mjeteve automobilistike në qytetin e Himarës” të Këshillit Bashkiak Himarë dhe Vendimit nr.15 datë 28.04.2026 “ Për miratimin e planit të punës, për menaxhimin e sukseshëm të sezonit turistik 2026 dhe planit të veprimit përkatës” të Këshillit Bashkiak Himarë:

Ju njoftojmë se në zbatim të Vendimit nr.15 datë 28.04.2026 “ Për miratimin e planit të punës, për menaxhimin e sukseshëm të sezonit turistik 2026 dhe planit të veprimit përkatës” të Këshillit Bashkiak Himarë, do të aplikohet “Miratimi i kahut të lëvizjes, orarit të lëvizjes dhe kufizimit të qarkullimit në disa akse të brendshme së mjeteve automobilistike në qytetin e Himarës sipas hartës bashkëlidhur këtij vendimi” duke filluar nga data 15/06/2026 sipas vendimit bashkëlidhur këtij njoftimi.

**KRYETARI
VANGJEL TAVO**

**NË MUNGESË DHE ME URDNËR
ZËVENDËSKRYETARI**

Erifili Berberi





REPUBLIKAE SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 5385 prot.

Himarë, më 11.07.2025

VENDIM

Nr. 34, Datë 09.07.2025

**PËR
“PËR MIRATIMIN E KAHUT TË LËVIZJES, ORARIT TË LËVIZJES DHE
KUFIZIMIT TË QARKULLIMIT NË DISA AKSE TË BRENDSHME SË MJETEVE
AUTOMOBILISTIKE NË QYTETIN E HIMARËS”**

Bazuar në ligjin nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjin nr. 8378/1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë” (i përditësuar datë, 16/03/2023), ligjin nr.89/2022 “Për policinë bashkiake”, VKM-në nr. 153, datë 07.04.2000 “Për miratimin e rregullores së zbatimit të Kodit Rrugor të Republikës Së Shqipërisë” (përditësuar me VKM nr.322, datë 29/05/2024); me propozim të Kryetarit të Bashkisë Himarë: Këshilli i Bashkisë Himarë në mbledhjen e datës 09.07.2025 , pasi shqyrtoi materialin e sjell drejtoria juridike e miratoi me trembëdhjetë (13) vota pro , tre (3) vota kundër , zero (0) abstenim dhe si më poshtë ,

VENDOSI

1. Miratimin e kahut të lëvizjes, orarit të lëvizjes dhe kufizimit të qarkullimit në disa akse të brendshme së mjeteve automobilistike në qytetin e Himarës sipas hartës bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohet Bashkia Himarë përmes sektorëve teknikë dhe urbanistikës, të vendosë sinjalistikën e nevojshme rrugore.
3. Ngarkohet Bashkia Himarë përmes Policisë Bashkiake të kontrollojë zbatimin e këtij vendimi.
4. Ngarkohet Bashkia Himarë përmes njësive të komunikimit të bashkisë të informojnë publikun për ndryshimet përmes mjeteve zyrtare dhe çdo forme të komunikimit.
5. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet administrata dhe Kryetari i Bashkisë Himarë.
6. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes publike, bazuar në ligjin nr. 139/2015 " Për vetëqeverisjen vendore", neni 55 pika 6.

KRYETARI
Dhimitër Kapaj





